

X H E V A T   M E H A

---

**Mendime parimore mbi organizimin  
e shqiptarëve në mërgim**

L O N D Ë R

Janar, 1998

**MENDIME PARIMORE MBI ORGANIZIMIN E  
SHQIPTARËVE NË MËRGIM**

Autor: **Xhevat Meha**

Lektor: **Xhemajl Peci**

LONDËR

Shkruar në shtator, 1997

Shtypur në janar, 1998

---

**E drejta e autorësisë**

Autori mban të drejtën e plotë të autorësisë. Rreptesisht ndalohet fotokopijimi, shumëzimi, shpërndarja, publikimi, dhe përdorimi për qëllime tjera pa marrjen e autorizimit nga autori.

## Shqiptarët dhe emigrimi

Me shekuj e dekada shqiptarët janë duke u larguar nga vendlinjet e tyre nga shkaqe dhe arsye të ndryshme. Me valën e fundit, qartazi shihet se ata do të jenë në numër të konsiderueshëm nëpër qytete dhe shtete të ndryshme, qoftë me punë e jetë të perkohshme, qoftë me punë e jetë të përhershme. Edhe në të kaluarën janë formuar shoqata, klube, koloni, etj. ku disa kanë bërë emër që edhe sot nderohen e respektohen, mirëpo ato janë krijuar e shuar, kurse po në të njëjtat qytete sot jetojnë një numer i madh i shqiptarëve, të cilët fillojnë të organizohen që nga e para. Ato subjekte krijuan shumë pasuri dhe të mira materiale dhe kulturore, por janë humbur e tretur ku vështirë u gjenden gjurmët. Do të kishte qenë mirë sikur një pjesë e këtyre pasurive kulturore e materiale të jenë të ruajtura për një shërbim dhe dobi të brezave të mëpastajmë. Në të sotmen dhe në të ardhmen një pjesë vitale e kombit do të jetoj e punoj nëpër vende të ndryshme. Një projekt i cili do t'u mundësonte mërgimtarëve tanë përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetës, zhvillim kulturor dhe të përgjithshëm, është më së i nevojshëm. Kjo do të kontribonte në masë të dukshme në integrimin e shoqërisë shqiptare dhe në forcimin e kombit.

Për llojin dhe cilësinë e emigrantëve shqiptar pajtohemi të gjithë se përpos që shumica prej tyre kanë dalë për bukën e gojës dhe mbajtjen e familjes, është edhe pjesa më e aftë, më e fortë, më vitale e kombit që u ndeshen me qeveri dhe regjime okupuese, apo edhe të tjerë që nuk gjetën mundësi të shprehjes a të zhvillimit të aftësive intelektuale e profesionale në vendet e tyre të lindjes. Të gjithë mërgimtarët nga Kosova e dëshirojnë, kanë nevojë dhe kanë interes në lirinë dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës, porse numri i atyre që kanë emigruar nga ndjekja e drejtpërdrejtë e pushteteve të ndryshme është shumë-shumë i vogël në krahasim me ata që kanë emigruar për plotësimin e nevojave për punë, shkollim, zhvillim të talenteve dhe aftësive profesionale, krijim të mirëqenjes dhe pasurisë etj. Nisur nga këto, është detyrë e jona që të gjejmë mënyrën për një ofrim më të madh ndaj njëri-tjetrit ku do të krijojmë kushte më të mira për punë, jetë dhe zhvillim aty ku jetojmë. Kjo do të ishte një ndihmë për njëri-tjetrin nga e cila dobia do të ishte e shumëfishtë, si ajo e drejtpërdrejtë për vet ne në mërgim, familjet dhe farefisin në vendlindje, po ashtu edhe për brezat e ardhshëm qoftë në vendlindje, apo në vendet ku po jetojmë e punojmë. Nuk ka munguar vullneti dhe dëshira për një ofrim e bashkëpunim në të kaluarën, nuk mungon as tani, dhe nuk do të mungojë as në të ardhmen. Problemi është se metodat e qasjes kanë qenë në mospërputhje me kërkesat e kohës dhe me nevojat e interesat praktike të individëve. Pas valës shumë të madhe të të shpërngulurëve në 5-6 vitet e fundit, dhe me përvojat e brezave të mëparshëm, e shoh si nevojë themelore por edhe si një mundësi praktike krijimin e bërthamave të shëndosha të subjekteve të ndryshme organizative, në përputhje me kërkesat e kohës dhe nevojat e interesat e bashkatdhetarëve. Kjo do të mundësonte lehtësimin e punës dhe jetës tonë në mërgim, ruajtjen e dinjitetit tonë kombëtar, si dhe ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës sonë të përgjithshme kombëtare.

## Vështrim mbi organizimin e shqiptarëve në Londër

Meqë punoj dhe jetoj në Londer, herë-pas-herë do t'i zë në gojë dhe do të bejë një vështrim personal mbi subjekte të caktuara organizative shqiptare të Londrës. Në fillim të viteve '90 kur subjektet e para u formuan, entuziazmi i individëve ishte i lartë. Në kohën kur në Londer llogariteshin të jenë afërsisht 500-600 shqiptarë, në një thirrje apo tubim qoftë të Klubit Shqiptar "Faik Konica" apo të LDK-së, tuboheshin 200-300 veta. Tani që numri i shqiptarëve është mbi 10,000 situata është krejt tjetër. Në fillim ruhej njëfarë barazpeshë dhe këto subjekte plotësonin deri në një shkallë nevojat dhe interesat e individëve. Klubi plotësonte nevojat për informim mbi zhvillimet në vendlindje dhe nevojat tjera kulturore, kurse LDK plotësonte nevojat në atë kohë të larta politike. Mendoj se kjo barazpeshë u prish kur filluan të paraqiten disa dukuri si: rënja e nevojave dhe interesave politike të individëve, dhe rritja e numrit të të ardhurve dhe nevojave të tyre. Kjo çoj kah disa paraqitje të reja ku Klubi më me vështirësi i përballonte kërkesat në rritje, kurse partitë politike filluan të merren me aktivitete tjera nga ato politike si: kulturore, sportive, mbledhjen e ndihmave solidare etj. Kur këtyre u shtohen dobësi të shumta në punë lehtësisht mund të kuptohet gjendja e tyre e tanishme. Para dy viteve u realizua iniciativa për formimin e Bashkësisë Shqiptare si një trup i vetëm, ku do të gravitonin të gjitha subjektet tjera organizative. Kjo solli probleme të reja për të ardhur deri në situatë ku në mbledhjet e Kuvendit të mbajtura në prill dhe

qershor të këtij viti, numri që këto kuvende arrinin t'u tërhiqnin vëmendjen nuk e kalonte 50-shin. Nevojat dhe interesat e bashkatdhetarëve janë po ato dhe në rritje, por numri i atyre që e gjejnë veten në këto subjekte ka rënë nga 50-60% në fillim të viteve '90 ( $300/500 \times 100 = 60\%$ ), tani në 0.5% ( $50/10,000 \times 100 = 0.5\%$ ). Teorikisht këtu në Londer ekzistojnë se paku edhe 199 Bashkësi Shqiptare me nga 50 anëtarë ( $199 \times 50 = 9,950$ ,  $9,950 + 50 = 10,000$ ). Shtrohet pyetja: "Çka e shkaktoj largimin e shqiptarëve nga subjektet e tyre organizative"? Prirë të them se baza mbi të cilën vepronin këto subjekte ishte tjetër nga njohja dhe përmbushja e nevojave, e interesave dhe e kërkesave individuale të bashkatdhetarëve, dhe se struktura e tyre e brendshme organizative lejonte lirshëm punën e përgjegjësi dhe sjelljet arrogante të individëve. Kjo gradualisht bëhej veçori dominuese e punës së tërë subjektit derisa shkaktoje pothuaj paralizim të plotë. Në një ambient të till njerëzit e sinqertë, të mirë e të ndergjegjshëm iritoheshin, dëshpëroheshin dhe largoheshin një nga një. Nën një dëshpërim të tillë, ata/ato humbnin çdo shpresë se mund të bëhet diçka e dobishme dhe e fillonin jetën pothuaj në vetmi, kontaktonin pothuaj vetem me dy-tre persona (shokë apo farefis). "Pijetoret", "Discot" e "Klubet e Natës" bëheshin vendi i gjetjes së prehjes, i kalimit të kohës dhe harxhimit të disa sterlingave në javë. Ky është përshkrimi i gjendjes në Londër e besoj se njëjtë apo ngjashëm është edhe në vendet e tjera. Është fakt se këtu në Londer jetojnë qindra të diplomuar në Univerzitetin e Prishtinës a të Tiranës, studentë për disa vite në këto univerzitate, dhjetëra a qindra të reja dhe të rinjë që po studiojnë këtu. Kjo flet për potencialet, mundësitë, dhe dobësitë tona.

### Kushtet e nevojshme për një organizim të mirë

Për një organizim të mirë dhe që subjekti organizativ të jetë "organizëm i shëndoshë" duhet që së paku të plotësohen dy kushte themelore: *i)* Baza mbi të cilën njerëzit do të tuboheshin, të jetë e qartë dhe e definuar mirë, dhe *ii)* Forma organizative të jetë e përshtatshme për realizimin e qëllimeve të formimit të subjektit.

*i) Baza mbi të cilën njerëzit do të tuboheshin të jetë e qartë dhe e definuar mirë* - Kjo bazë do të ishte plotësimi i nevojave, interesave dhe kërkesave individuale të bashkatdhetarëve aty ku punojnë e jetojnë. Vetë nevojat, interesat, dhe kërkesat se pari do të duhej të njiheshin, definoheshin e përfillëshin. Pastaj do të gjendej mënyra më e përshtatshme për plotësimin e tyre. Këtu e kam fjalën për nevojat që individi i ka të përbashkëta dhe që më lehtë i plotëson si grup (në këtë rast etnik), ndërsa nevojat vetëm individuale i plotëson secili veçmas. Për njohjen e nevojave do të përpiqem të japë një ndriçim duke i përmendur disa nga nevojat e bashkatdhetarëve që gjithsesi nuk janë të vetmet. Shembull: - Nevoja për të qenë pranë njeri-tjetrit; Nevoja për informim të paanshëm mbi zhvillimet në vendlindje; Nevoja për zbavitje dhe argëtim; Nevoja për arsimim shqip të fëmijëve; Nevoja për shfaqje kulturore; Nevoja për politikë; Nevoja për njohjen me zhvillimet e shqiptarëve në mërgim; Nevoja për njohjen e kushteve dhe mundësive për punë, studime, biznes, etj. në vendet ku jetojnë dhe në vendet tjera; Nevoja për aktivitete sportive; Nevoja që ndihma e organizuar solidare të mos vidhet; Nevoja për shkëmbime kulturore me popujt tjerë; etj. Plotësimi i këtyre dhe i nevojave të tjera vetëvetiu do mundësonte plotësimin e një mbinevoje: **Nevoja për identifikim me krenarinë e emrit shqiptar**. Vlenë të theksohet se me përjashtim të fillimit të punës të Klubit Shqiptar, pothuaj asnjë nga subjektet organizative këtu në Londer nuk e ka bërë një definim të mirëfilltë të këtyre nevojave. Për njohjen e nevojave është mirë të dihen çka mërgimtarët nuk kanë nevojë. Mërgimtarët nuk kanë nevojë për informim të "formuar", nuk kanë nevojë për shfaqje të rrejtshme kulturore, nuk kanë nevojë për vjedhjen e ndihmave të organizuara për vendlindjen, nuk kanë nevojë për parti politike a qeveri që ua rrisin problemet, nuk kanë nevojë që dikush në emër të interesave të tyre të luajë me nevojat e tyre, etj.

*ii) Forma organizative të jetë e përshtatshme për realizimin e qëllimeve* - Që forma organizative të jetë e përshtatshme për realizimin e qëllimeve të organizimit, struktura e brendshme duhet të siguroj definimin dhe punën e lirshme të tri funksioneve:


1. Funksionet e vendosjes,
2. Funksionet e kryerjes apo ekzekutimit, dhe
3. Funksionet e kontrollit.

Praktika e deritanishme e subjekteve organizative këtu në Londër nuk ka treguar një definim dhe punë të mirëfilltë të këtyre funksioneve. Funksionet e vendosjes dhe kryerjes kanë qenë të përziera kurse funksionet e kontrollit ose kanë munguar plotësisht ose kanë qenë shumë të brishta. Duhet të theksohet se Bashkësia Islame Shqiptare ka pasë numër të vogël të anëtarëve por ka dhënë kontributin më të madh ndaj bashkatdhetarëve dhe vendlindjes. Kuptohet se kur numri i anëtarëve është shumë i vogël, një ndarje e tillë e funksioneve është e pamundshme.

## Modeli i Bashkësisë Kulturore Shqiptare

Mendoj se nevojat, interesat, dhe kërkesat individuale të bashkatdhetarëve janë të shumta, të ndryshme, dhe jo aq lehtë të plotësueshme. Një subjekt organizativ i vetëm, kurrë nuk do të jetë në gjendje të bëjë plotësimin e tyre. Ekzistimi i disa subjekteve është i nevojshëm. Përpjekjet e mia do t'i kisha përqëndruar në një subjekt, që mendoj se mund dhe do të duhej të tubonte numrin më të madh të bashkatdhetarëve. Këtë do ta quajë Bashkësia Kulturore Shqiptare, ku aktivitetet kulturore do të ishin kryesore. Pikëpamjet e mia do t'i parashtroja në formë të një modeli parimor. Në pika të caktuara mund të ketë përputhje në mes të parashtrimit tim dhe punës së deritanishme të subjekteve të ndryshme organizative, por meqë është fjala për model, nevoja për kompletësi kërkon që ai të prezantohet si një tërësi. Do të dëshiroja që punimi në fjalë vetëm të shtrojë parime të drejta mbi të cilat do të mund të ndërtohej Bashkësia, shkurtimisht, pa u lëshuar në hollësi, duke u përqëndruar vetëm në komizën e përgjithshme. Hollësitë dhe veçantitë praktike do të përcaktoheshin dhe përshtateshin sipas rrethanave dhe vendit ku ato formohen. Shembujt e përdorur nganjëherë në punim kanë rolin vetëm të udhërrëfimit. Atë do ta përmbledh në katër pika:

1. Mbajtja e regjistrimit të anëtarëve të Bashkësisë Kulturore Shqiptare,
2. Zgjedhja e delegatëve, formimi i Kuvendit, zgjedhja e Kryesisë dhe e grupeve të punës,
3. Mbajtja e regjistrimit të pasurisë së Bashkësisë.
4. Aplikimi i "minimumi të nevojshëm" i formës me shkrim në komunikimet e brendshme dhe të jashtme



*Paraqitja skemore e Kuvendit të Bashkësisë Kulturore Shqiptare*

**1. Mbajtja e regjistrimit të anëtarëve të Bashkësisë** - Ky regjistër do të vënte kufirin e dallimit të anëtarëve dhe joanëtarëve. Anëtarësimi do të ishte në baza vullnetare pa dallime të përkatësisë regjionale, politike, fetare etj dhe ku do të paguhej anëtarësia. Çmimi i anëtarësisë do të caktohej nga Kuvendi varësisht nga lloji dhe niveli i shërbimeve që Bashkësia do t'i marrë përsipër t'u ofroj anëtarëve. Caktimi i kriterëve për njohjen dhe humbjen e statusit të anëtarit të Bashkësisë do të ishte i nevojshëm. Shembull: njohja a statusit do të bëhej me pagimin e rregullt të anëtarësisë, kurse humbja do të bëhej nëse anëtarësia nuk paguhet për 6 muaj apo nëse anëtari me sjelljen e vet bënë dëm të madh ndaj Bashkësisë dhe këtë e

verteton Kuvendi. Rritja apo zvoglimi i numrit të anëtarëve do të tregonte për punën e mirë apo të keqe të Bashkësisë.

**2. Zgjedhja e delegatëve, formimi i Kuvendit, zgjedhja e Kryesisë dhe e Grupeve të punës** - Në bazë të numrit të anëtarëve të Bashkësisë do të duhej të caktohej mënjura e veprimt. Nëse Bashkësia ka 100 apo më pak anëtarë, atëherë anëtarët do të udhëheqëshin drejtpërdrejt, do ta zgjedhin Kryesinë dhe Grupet e Punës. Bashkësia njëkohësisht do të ishte Kuvend. Nëse Bashkësia do të kishte 300 anëtarë, një Kuvend prej afërsisht 50-60 delegatësh do të ishte i nevojshëm e kështu më radhë. Delegatët e Kuvendit do të ishin me mandat dyvjeçar. Kuvendi do ta zgjedhte: *i)* Kryesinë e Bashkësisë, dhe *ii)* Grupet e Punës.

*i) Kryesia e Bashkësisë* - Do t'i drejtonte dhe harmonizonte punët e veçanta të përcaktuara nga Kuvendi. Mandati i Kryesisë do të caktohej nga Kuvendi dhe mund të jetë një apo dyvjeçar. Anëtarët e Kryesisë e sidomos Kryetari, do të mbanin kontakte të drejtpërdrejta me kryetarët e grupeve, do të këshillonte punën e tyre, do t'u ofronte ndihmë në kapërcimin e problemeve, dhe do të koordinonte veprimtarinë e përgjithshme të grupeve. Po qe se Kryesia e sheh të nevojshme, në raste të veçanta (psh në mes të mbledhjeve të Kuvendit), do të kishte autorizimin nga Kuvendi që ta formojë apo ta ndërrojë grupin. Për këtë veprim, Kryesia në mbledhjen e parë të Kuvendit, do ta paraqiste arsyetimin para delegatëve për miratim. Kryetari dhe anëtarët e kryesisë nuk do të kishin të drejtë të jenë kryetar apo anëtarë të grupeve. Kryetari do të përfaqësonte Bashkësinë në kontakte me palët tjera. Kryesinë dhe Kryetarin do t'i emëronte Kuvendi.

*ii) Grupet e Punës* - do të formoheshin me karakter dhe qëllime të ndryshme, varësisht nga nevoja. Shëmbull: për punët e sportit - një grup, për informim - një grup, për thirrjen dhe udhëheqjen me punët e Kuvendit - një grup, etj. Parimisht grupi do të zgjedhej nga Kuvendi dhe do t'i përgjigjej po atij. Në raste të veçanta, do të mund të formohet nga Kryesia. Parimisht kryetari i grupit do të ishte gjithashtu delegat, kurse anëtarët e grupit mund të jenë delegatë, anëtarë të Bashkësisë, apo persona të tjerë jashtë Bashkësisë. Numrin, llojin, dhe përbërjen e grupeve do ta caktonte Kuvendi.

Kuvendi do të merrte vendime, do të udhëhiqte me punën e përgjithshme, dhe do ta kontrollonte dhe korrigjonte punën e Bashkësisë. Ai do të ishte përgjegjës për ngritjen apo rënjen e veprimtarisë së përgjithshme. Caktimi i Kryesisë dhe grupeve do të bëhej nga Kuvendi dhe puna e tyre do vlerësohej po aty. Kuvendi do t'i caktonte drejtimet kryesore të aktiviteteve për të ardhmen, kurse Kryesia dhe grupet do t'i hartonin programet e punës së marrë përsipër në mandatin e tyre. Kuvendi do të mbledhej së paku 4 herë në vit për të debatuar dhe vlerësuar punët dhe programet e Kryesisë dhe të grupeve, si dhe punën e gjithëmbarshme të Bashkësisë. Kuvendi do të përgaditej, thirrej, dhe udhëheqej nga një grup i veçantë e jo nga Kryesia. Delegatët do të kishin të drejtë të interesohen, njohin, dhe kontrollojnë punën e individëve, grupeve, Kryesisë apo të kryetarit por nuk do të kishin të drejtë ta pengojnë atë. Kuvendi do të merrte vendim që kryetarët dhe anëtarët e kryesive të grupeve politike në ato venbanime të mos kenë të drejtë të zgjedhen kryetar, anëtarë të Kryesisë, dhe kryetar të grupeve të Bashkësisë. Kjo do të bëhej sa për të bërë ndarjen dhe dallimin e Bashkësisë si kulturore dhe të grupeve politike si grupe me përcaktime politike. Anëtar të Bashkësisë do të jenë edhe joanëtarët e ndonjë partie politike edhe anëtarët dhe përkrahësit e partive të ndryshme politike. Anëtari i Bashkësisë lirisht do të mund të zgjedhej në cilëndo pozitë të partisë së tyre politike. Kuvendi i Bashkësisë nuk do të kishte të drejtë merrte asnjë qëndrim politik. Suksesi i punës së Bashkësisë do të varej në punën e Kuvendit. Suksesi dhe rezultati i punës së Kuvendit do të matej me ngritjen apo rënjen e numrit të anëtarëve të Bashkësisë si rezultat i ngritjes apo rënjes së interesimit. Puna e mirë do të thotë se Bashkësia po i plotëson nevojat dhe interesat e bashkatdhetarëve, gjë që do të shprehej në shtimin e interesimit. Puna e dobët do të dëshmojë të kundërtën dhe do t'i iritojë bashkatdhetarët.

**3. Mbajtja e regjistrimit të pasurisë së Bashkësisë** - Me qëllim të zhvillimit të veprimtarisë, meqë Bashkësia do të këtë mjete në përdorim, do të ishte normale që në çdo kohë e në çdo moment të dihet gjendja dhe levizja e saktë e tyre nga cilido anëtar i Bashkësisë. Është shumë me rëndësi një procedurë e qartë në këtë sferë. Çdo transakcion me mjetet e Bashkësisë do të ishte i dokumentuar, dhe mbajtja e plotë e shënimeve do të ishte terësisht e detyrueshme. Në punët në lidhje me përdorimin e mjeteve dhe mbajtjen e shënimeve duhet të jenë të angazhuar se paku tre persona, me një ndarje të qartë të punëve, ku

secili do të ishte përgjegjës vetëm për punët e ngarkuara. Një person do të duhej që vetëm të bëjë përdorimin e mjeteve (p.sh. pagesat), një person tjetër vetëm të bëjë autorizimin e pagesave, dhe një person krejt tjetër të bëjë vetëm mbajtjen e shënimeve. Për secilën nga këto punë personat përgjegjës duhet të jenë të ndarë ku njëri nuk do të kishte të drejtë të përzihet në punët e tjetrit. Personi që bën autorizimin e përdorimit të mjeteve vetëm do të nënshkruante dhe mbikëqyrte pagesat dhe nuk do të kishte të drejtë të bëjë vet pagesat apo të bëjë ndonjë shënim në librat e mbajtura e kështu me radhë. Gjithashtu, format e pranimit të mjeteve duhet të jenë të definuara, të dokumentuara, dhe të njohura qartazi. Për mjetet e pranuar në të gatshme, "bllokat" dykopsësh dhe me fletë të paranimëruara do të duhej të përdoreheshin. Bashkësia duhet ta ketë vitin financiar ku llogaria vjetore do t'i paraqitet Kuvendit për miratim. Llogaria financiare e miratuar nga Kuvendi do të ishte publike dhe nga një kopje do t'u dergohej secilit anëtar të Bashkësisë. Se paku një herë në vit një grup i pavarur do të caktohej për kontrollimin e mjeteve dhe mbajtjes së shënimeve. Kur pasuria e Bashkësisë është e mbrojtur nga vjedhja dhe keqpërdorimi, e ruajtur dhe e mirëmbajtur për brezat e tjerë, anëtarët më me lehtësi do të derdhnin mjetet në dobi të Bashkësisë bile ndoshta edhe do të bëheshin kontribute vullnetare. Individët do ta ndjenin pasurinë e Bashkësisë si pasuri kombëtare. Me një punë të tillë anëtari i Bashkësisë do të ndjehej mirë dhe i sigurt, se kontributi i tij apo saj është duke u përdorur në pajtim me qëllimet dhe nevojat e tyre.

**4. Aplikimi i "minimumit të nevojshëm" i formës me shkrim në komunikimet e brendshme dhe të jashtme** - Zhvillimi i aktiviteteve në bazë të modelit të parashtruar vetvetiu kërkon një shkallë të caktuar të formalizimit të punës. Ndarja e tillë e punëve dhe aplikimi i parimit të përgjegjësisë kërkon që për të ardhur deri te një përfundim i pranueshëm, nevojitet evidencë formale (shkrim/dokument). Në shikim të parë duket se kjo i rritë shpenzimet, por po të zbatohet drejt, kjo formë e komunikimit do të deshmohej si më e racionalë, sidomos në eliminimin e diskutimeve të gjata, boshe, a jofrytdhënëse, që është dukuri e jona e përgjithshme. Shembull: vendimet e marra në Kuvend, raportet e punës, programet, detyrat, propozimet a planet e ndryshme etj. Në lidhje me këtë "minimum të nevojshëm" do të vendoste Kuvendi.

### **Cilësitë e punës së Bashkësisë përmes Kuvendit**

Bashkësia e formuar me Kuvend në bazë të këtij modeli do të ishte një institucion qytetar i formuar dhe i kontrolluar nga qytetarët në bazë të interesave dhe nevojave të tyre. Do të ishte i hapët dhe i barabartë për cilindo shqipfolës e nga cilado përkatësi regjionale, qoftë nga Kosova, Maqedonia, Shqipëria apo nga regjionet tjera. Po ashtu anëtarë të barabartë do të ishin anëtarë të cilësdo partie politike, mbajtës apo përkrahës të cilësdo bindje politike. Po ashtu qytetarë e katundarë do të trajtoheshin pa dallim - d.m.th. si shqiptar. "Bisnismen", "Politikan", "Shkollar", "Taxist", "Kuzhinier", "Ndërtimtar", do të paguanin anëtarësi të njëjtë dhe do të merrnin shërbime të njëjta nga Bashkësia. Kjo do të ishte një përzierje dhe një ulje pranë njëri-tjetrit (gju-me-gju dhe ballë për ballë) me të gjitha të mirat e të këqijat që i kemi. Më vjen keq për ata/ato që nuk e përballojnë një perzierje të tillë. Ta njohësh realitetin dhe të jetosh me të, kjo është kryesorja. Kjo përzierje do të krijonte mundësinë e shijimit të pasurisë së llojllojshmërisë që e kemi. Nëse Kuvendi e kryen punën e vet si duhet, këtë pasuri do t'a shfrytëzonte drejt dhe do të krijonte kushte të volitshme për zhvillime tjera pozitive. Personi do të kontribonte me çmimin e anëtarësisë së paguar dhe atë do ta krahasonte me shërbimet për plotësimin e nevojave të veta të marra nga Bashkësia.

Puna përmes Kuvendit do të bënte të mundur ndarjen e punëve dhe të përgjegjësisë nëpër individ dhe grupe. Secili do ta dinte rolin, përgjegjësinë dhe punën e vet. Po ashtu roli, puna, përgjegjësia dhe kontributi i individëve do të jenë të njohshme dhe vlerësueshme për secilin nga delegatët dhe nga Kuvendi. Kordinimi i tyre do të ishte detyrë dhe përgjegjësi e Kryesisë. Kuvendi do të bënte mbikëqyrjen dhe harmonizimin e përgjithshëm. Kjo do të siguronte që Bashkësia të ketë minimumin e nevojshëm të rregullave për funksionim si dhe fushëveprimin e lirë të individëve dhe aktiviteteve, pa ardhur deri tek rregullat e tepërta, të ngurta dhe të panevojshme. Mundësia që çdo tre muaj secili delegat të njihet me punën e të tjerëve dhe ta bëjë shprehjen e lirë të mendimeve të veta, do të krijonte kushte të barabarta për secilin. Kjo mundësi e barabartë e dëshimit të aftësive individuale krijon një konkurrencë të brendshme,

aq të nevojshme për subjektet tona organizative. Ky do të ishte motori i çuarjes së punëve përpara. Kjo do të ishte forma që do të krijonte kushte të volitshme që individi ta gjejë veten në Bashkësi, të japë ndonjë kontribut, të dijë për rezultatet e kontributit të tij apo të saj dhe që mundi dhe përpjekja drejtpërdrejt të njihen, të çmohen dhe të vlerësohen nga Kuvendi e Bashkësia. Gjithashtu sjellja e keqe, dobësia, apo arroganca, qoftë e individit apo e grupit, do të jenë të njohura dhe të vlerësuara aty për aty nga Kuvendi. Jo vetëm kaq, Kuvendi do të kishte fuqinë që të marrë vendime për ndryshime, t'i eliminojë ato pengesa, dhe në këtë mënyrë të çajë rrugën përpara. Në këtë mënyrë do të heqej mjegulla në dallimin e këtyre tipareve personale të individëve. Kur e përmend Kuvendin mendoj në një Kuvend të respektuar, me delegatë të zgjedhur, të aftë dhe të merituar. Kuvendi i parë i zgjedhur mund të mos i ketë të gjitha këto veti, por jam thellë i bindur se shumica e delegateve do të jenë të merituar, kështu që shumica do ta mbizotëronte tërësinë.

Një model i tillë i punës ka strukturën e brendshme e cila do të krijojë Bashkësinë si një "organizëm të shëndoshë", me funksionet e nevojshme për vetëmbajtje dhe zhvillim. Kuvendi do të ishte prurës i vendimeve, Kryesia dhe grupet e punës do të ishin kryerës apo ekzekutues të tyre, dhe kontrollin do ta bënin delegatët, qoftë përmes hetimit dhe interesimit në lidhje me punën e Kryesisë, grupeve të punës dhe idividëve, apo drejtpërdrejt nga puna në Kuvend. Kuvendi po ashtu mund të krijojë grupe të veçanta hulumtimi dhe kontolli për çështje apo punë të caktuara. Gabimet dhe dobësitë e shfaqura shpejt do të hetohen, vërtetohen, dhe eliminohen me një zgjidhje të dobishme për Bashkësinë. Në këtë mënyrë do të sigurohej stabiliteti, harmonia dhe kontolli i nevojshëm që Bashkësia të jetë një institucion në funksion të anëtarëve që e kanë formuar atë. Një Bashkësi e tillë do të ishte subjekt i vetëmbajtur, struktura e të cilit mundëson ndryshim dhe përshtatje, zhvillim, ecje përpara dhe përparim të vazhdueshëm.

Bashkësitë e tilla me Kuvende do të ishin të përhershme përderisa shqiptarët do të jetonin nëpër ato vende. Anëtarët, delegatët, organet e zgjedhura nga Kuvendi, individët do të shkojnë e vijnë, por të mirat materiale, kulturore e të tjera do të mbosin aty të ruajtura për ata që në ato momente janë anëtarë dhe atyre që do të vijnë. Në këtë mënyrë Bashkësia Kulturore Shqiptare do të ishte e përhershme, e fuqishme, e qëndrueshme, dhe do të ishte shtyllë e vertetë e zhvillimit tonë kulturor dhe e zhvillit të përgjithshëm kombëtar.

## **Marrëdhënjet e caktuara të punës së Bashkësisë**

Me punën e vet Bashkësia do të krijoj raporte të reja nga praktika e deritanishme. Këto raporte do të shprehën në marrëdhënie dhe relacione të ndryshme si: marrëdhënjet në mes të individëve, individit dhe Bashkësisë, anëtarit dhe Bashkësisë, Bashkësisë dhe organeve lokale të pushtetit, Bashkësisë dhe kulturave të popujve tjerë, Bashkësisë dhe grupeve të ndryshme politike, Bashkësisë dhe subjekteve tjera organizative, Bashkësisë dhe qeverive shqiptare, etj. Të gjitha këto marrëdhënie të përmendura si dhe marrëdhënjet tjera kanë një rëndësi të madhe për punën e Bashkësisë, por unë në mënyrë të veçantë do të përpiqem të shtjelloj tri marrëdhënjet të fundit të cekura më lartë.

## **Marrëdhënjet e Bashkësisë me grupet e ndryshme politike**

Në parim nuk do të duhej të kishte asnjë problem a konflikt interesash në mes të Bashkësisë dhe partive apo grupeve të ndryshme politike. Ato lirisht mund të bashkëjetojnë të ndara, por pranë njëra-tjetrës me një bashkëpunim të ndersjelltë. Do të doja të japë një mendim personal në lidhje me punën e grupeve politike jashtë trojeve tona. Mendoj se roli i tyre duhet të jetë i ndryshëm nga ai që po e luajnë tani. Marrja e grupeve politike me punë të tjera jopolitike po e ngulfatë, po e pengon, dhe po e dëmton zhvillimin e aktiviteteve tjera të mërgimtarëve. Shqiptarët i kuptoj si shumë të sinqertë në shpirt. Përkatësia e tyre politike më ngjanë me sinqeritetin e dashurisë së parë. Kurrsesi të shohin ndonjë anë apo veti të keqe në partinë e tyre dhe mendojnë se për të duhet luftuar deri në fund me të gjitha mjetet. Nuk e shoshitin se sa ajo më të vërtetë e meriton një gjë të tillë, është serioze dhe se a punon në përputhje



me bindjet, besimet dhe interesat e tyre. Po të merret si e vërtetë ajo që shumë po mendojnë se “politika është lavire”, gjendja e këtyre të dashuruarve është e qartë. Energji të çmueshme kombëtare janë duke u harxhuar në disa shtyerje të panevojshme në mes veti pa ndonjë bisedim të kulturuar, racional, bindës, frytdhënës, të argumentuar dhe me rezultate konkrete. Sidomos nuk i kuptoj “të flaktit” që aq shumë i jepin “zjarr” gjërave të cilat unë dyshoj se ata vetë u besojnë. Të mbushet mendja se kanë emigruar për ta çliruar Kosovën. Është shumë normale që individi të ketë bindje të ndryshme politike, t’i përket ndonjë partie politike, apo të jetë përkrahës i ndonjë grupi politik. Nevoja politike është një nga nevojat e shumta të bashkatdhetarëve. Puna e mirëfilltë politike e grupeve politike do të ishte e çmueshme për bashkatdhetarët dhe për nevojat e tyre. Shqiptarët, si ata në trojet shqiptare ashtu edhe ata në mërgim e ndjejnë se u mungojnë politikanë të mirëfilltë që gjejnë zgjidhje të drejtë të problemeve dhe të halleve të tyre. Ata e dëshirojnë dhe e mirëpresin zhvillimin e mendimit politik. Mendoj se grupet politike duhet të vazhdojnë punën e tyre si të veçanta në zhvillimin dhe përhapjen e mendimit politik ndër mërgimtarët porse nuk çmohet përzjerja e panevojshme e tyre në veprimtari të tjera. Kjo do sillte gjendjen që individët me talente politike do të merreshin me punë politike, ata me talente të kulturës me punë të kulturës, ata me talente të sportit me punë sportive etj. Bashkësia do t’u ofronte ndihmë të madhe partive politike por edhe ka nevojë për ndihmën e tyre. Ndihma e Bashkësisë për grupet politike do të ishte se ajo do të grumbullonte një numër të madh të bashkatdhetarëve ku ato lehtësisht do të mund t’i drejtonin porositë e tyre kurse ndihma e grupeve politike për Bashkësinë do të ishte mendimi politikisht i drejtë që grupet politike do t’i drejtonin anëtarëve të Bashkësisë. Bashkësitë lirisht do të organizonin pritje dhe takime me politikanë të ndryshëm, tryeza, biseda, e diskutime politike si një nga aktivitetet për plotësimin e nevojave të anëtarëve. Anëtarët e Bashkësisë lirisht do të bisedonin dhe shprehnin mendimet e tyre dhe se ato do të ishin vetëm personale dhe individuale. Kuvendi i Bashkësisë nuk do të merrte asnjë qëndrim politik. Kuvendi i Bashkësisë do të caktonte rregullat dhe mënyrën e bashkëpunimit me grupet politike.

## **Marrëdhënjet e Bashkësisë me subjektet tjera organizative**

Nevojat, interesat, dhe kërkesat e bashkatdhetarëve në mërgim janë të shumta dhe të llojllojshme. Shumica e tyre do të plotësoheshin më lehtë po qe se një numër më i madh i tyre do të bashkoheshin nën një çati. Grumbullimi i potencialeve njerëzore, materiale, mendore, kulturore, etj. do të krijonte një bazë të fuqishme dhe kushte të volitshme për një përdorim të tyre frytdhënës. Mirëpo kjo gjithashtu krijon problemet e harmonizimit, kordinimit, kontrollimit dhe përdorimit racional të potencialeve. Grupe të caktuara kurdoherë do të kenë nevoja dhe interesa specifike e të veçanta të cilat më lehtë dhe më mirë do të plotësoheshin nën organizime të veçanta. Nisur nga këto, normalisht krahas Bashkësisë do të veprojnë edhe subjekte tjera organizative. Kjo do të ishte shumë e dobishme sepse do të krijoheshin gjendja e konkurrencës së jashtme si një motor i shtyrjes dhe zhvillimit përpara. Shembull: Një shoqatë e pavarur sportive me grupin për punë sporti të Bashkësisë, apo një shoqatë e studenteve me grupin për punë me të rinjtë e Bashkësisë etj. Ideja e futjes nën një çati e të gjitha subjekteve organizative shqiptare që veprojnë në një vend u provua në Londër, dhe u tregua e pasuksesshme dhe e panevojshme. Subjektet tjera organizative nën këso gjendje e ndjejnë se futen nën tutelën, kontrollin dhe dirigjimin e tjetërkujt dhe e humbin veçantinë e tyre. Nevojat, interesat, dhe kërkesat sado të veçanta e specifike të jenë, nuk do të jenë aq të ndara sa mos të kenë nevojën e bashkëpunimit dhe të ndërlidhjes me subjektet tjera shqipfolëse. Ndërlidhja dhe bashkëpunimi do të arrihej me formimin e një Këshilli të Përbashkët, me përfaqësues nga të gjitha subjektet dhe me një pjesëmarrje në bazë të numrit që posedon subjekti. Shembull: Për çdo 20 anëtarë të regjistruar subjekti do ta dërgonte një përfaqësues. Ky këshill do të takohej rregullisht ku do të dilte me këshilla të veçanta për çështje të ndryshme. Keto këshilla nuk do të ishin vendime obliguese. Të gjitha subjektet kanë nevojë për këshilla dhe për bashkëpunim e ndërlidhje. Këshillat e drejta dhe të mira do të jenë të mirëpritura dhe të zbatueshme nga të gjitha subjektet organizative shqiptare.

## Marrëdhënjet e Bashkësisë me qeveritë shqiptare

Qeveritë shqiptare, qoftë ajo e Shqipërisë, e Kosovës, apo qeveritarë shqiptarë në qeverinë e Maqedonisë mandatin e tyre e marrin nga shqiptarët që jetojnë në ato troje. Meqë lidhjet familjare dhe interesa të ndërsjellta ekzistojnë në mes tyre dhe mërgimtarëve, ato qeveri do të jenë të ndikuara nga vullneti dhe përkrahja e njerëzve në mërgim. Qeveritarët kanë nevojë për një formë të përshtatshme komunikimi me mërgimtarët. Po ashtu edhe mërgimtarët kanë nevojë për një mundësi të përshtatshme të shprehjes së vullnetit të tyre në lidhje me problemet në vendlindjet e tyre. Bashkësia e një forme të paraqitur më lartë ofron një mundësi të përkryer në këtë drejtim. Shqiptarët, si ata në trojet e veta, ashtu edhe ata në mërgim, e ndjejnë se kurrë në histori të tyre nuk kanë pasur një qeveri që i ka përvjelur mëngët me gjithë mend dhe me gjithë zemër për zgjidhjen e problemeve të tyre. Në treg, kur nuk gjendet malli i cilësisë së nevojshme, paguhet ai që gjendet. Në mungesë të qeverive që kanë nevojë, ata i respektojnë edhe qeveritë e dobëta. Ndryshe nga çirrijet, bërtitjet, ankimet a rrënkimet në rrethe të ngushta e joformale, ato do të bëheshin në tubimet e Bashkësisë me një ballafaqim të kulturuar të mendimeve të ndryshme në mes të anëtarëve. Kurrfarë vendimi nuk do të merrej porse disponimi i shumicës do të ishte edhe vullneti që bashkatdhetarët do ta përfaqësonin. Duke marrur parasysh parimet e mospërzjerjes së Bashkësisë në zhvillime politike të cekura më lartë, ndihma e drejtëpërdrejtë e qeverive për mërgimtarët dhe ajo e mërgimtarëve për qeveritë, nëpërmes Bashkësisë, do të jetë normale dhe e pranuar nga të gjithë.

## Përparësitë dhe anët e mira të punës së Bashkësisë

Puna e Bashkësisë në bazë të këtij modeli do t'i ketë disa përparësi ndër të cilat:

- *Mundësia e të shprehurit të lirë të mendimit* - Aty ku mungon ballafaqimi i lirë i mendimeve, mungon njohja e realitetit, mungon dija dhe mungon gjetja e rrugës për të ecur përpara, d.m.th. mbizotëron padituria dhe errësira. Anëtarësimi i lirë për të gjithë të interesuarit, mbledhjet e Kuvendit në çdo tre muaj, zgjedhja me vota të lira të delegatëve dhe shprehja e lirë e mendimeve të tyre, do të krijojnë një ambient ku individit do të jetë në gjendje që jo vetëm ta shprehë mendimin e tij/e saj lirisht, por që edhe ai mendim të përfillet e respektohet. Kjo mundësi do t'i krijoj Bashkësisë jetë, zhvillim e përparim të përhershëm.
- *Konkurrenca e brendshme në mes individëve* - Kushtet e njëjta dhe të barabarta të individëve për regjistrim, punë dhe aktivitet, angazhim dhe shprehje, njohje dhe vlerësim nga të tjerët, do të thotë që individët të jenë në pozita të barabarta. Nisur nga e kaluara jonë, një gjë e tillë e mirëfilltë ka munguar në jetën dhe institucionet tona. Aty ku nuk ka konkurrencë të mirëfilltë, nuk ka cilësi, ecje përpara, dhe zhvillim. Kjo do të jetë një cilësi e re dhe aq e nevojshme ndër ne. Një konkurrencë e tillë do të bëjë seleksionim të natyrshëm të individëve në bazë të aftësive, talentit, dhe zotësive, dhe do të jetë fuqia e shtyerjes përpara të zhvillimeve.
- *Zhvillimi i një kulture të mirëfilltë* - Të punuarit dhe të vepruarit në një institucion që ofron mundësi të barabartë të shprehjes së mendimit, veprimit, dhe të vlerësimit të tyre për të gjithë, vetvetiu do të thotë edhe zhvillim i kulturës së mirë njerëzore. Individit nuk do të jetë në gjendje që ta bëjë ndonjë "idiotësi" apo "fëlliqësirë", ta mbulojë atë, dhe t'a tregojë "faqen e bardhë" para të tjerëve. Karakteri, personaliteti, vetitë dhe cilësit personale, aftësia, dobësia etj. do të jenë të shprehura dhe të njohura ashtu siqë më të vertet individit i posedon.
- *Tejkailimi i dallimeve jo të natyrshme në shoqërinë tonë* - Barabarësimi në çmimin e anëtarësisë dhe marrjen e shërbimeve nga Bashkësia, do të bëjë të tregojë të panevojshëm dallimin jonatyor dhe identifikimin e individëve si: "qytetar", "katundar", "llapjan", "gjakovar", "lab", "malok", "maqedonc", "demokrat", "i lëvizjes", "socialist", "komunist", "biznismen", etj. Asnjë përfitim nga këto "identifikime". Një cilësi e tillë e re për momentin është e nevojshme për shoqërinë shqiptare.

- *Njohja, vlerësimi, dhe matja e kulturës, kontributit dhe punës së individit* - Në një përzierje dhe barabarsim të tillë, do të vie deri tek një ndeshje në mes të dy pjesëve të kulturës sonë: kultura e rrenës, e mashtrimit, e dredhisë, e josinqeritetit, etj. dhe e asaj të punës dhe kontributit të sinqertë, përgjegjëse, serioz, frytëdhënës, etj. Me ndihmën e regjimeve okupuese dhe atyre jopopullore, ajo e para ka qenë mbizotëruese ndër shqiptarët, dhe ende është shumë e fuqishme në punën e subjekteve tona organizative. Ky krimb i brendshëm është një mekanizëm i fuqishëm i shkatërrimit të qenjes sonë kombëtare. Kjo farë e fëlliqur është mbjellur me shekuj dhe ende është duke u mbjellur! Kjo është ngulitur aqë thellë në kokat e individëve saqë ende nuk po arrijmë të krijojmë ndonjë institucion të qëndrueshëm, pengesë kjo që po e shkatërron përbrenda atë pjesën e dytë të kulturës dhe në këtë mënyrë edhe tërë qënjen tonë kombëtare. Një Bashkësi me mënyrën e tillë të punës ku çdo gjë do të jetë aq e afërt, e njohur dhe e vlerësuar nga shumica e delegatëve do mundësojë matjen e kontributit apo dobësisë së individit. Kjo do bënte që kjo pjesa e dytë e kulturës të mbizotërojë atë pjesën e parë dhe të jetë veçori e përgjithshme.
- *Të njohurit e pasojave të veprimeve* - Është veçori e jonë e përgjithshme që pasojat e veprimeve tona nuk i njohim. Kjo rrjedh nga logjika që “për një plesht ta djegë jorganin” dhe temperamentin i vullshëm dhe i tepërt që e kemi. Kjo vie në shprehje kur interesin e vogël personal e vëjmë para çdo gjëje dhe nuk i shohim pasojat e shkatërrimit të interesit tonë të përbashkët. Shpeshherë dobia nga pjesa e interesit personal si pjesë e tërësisë së interesit të përbashkët është më e madhe sesa interesi i ngushtë personal i veçuar. Ketë as nuk e shohim e as nuk e njohim. As nuk jemi në gjendje t’i njohim dhe t’i çmojmë anët pozitive të ndonjë nisme të individit përpara se ajo të ndermirret, as nuk i njohim dhe vlerësojmë pasojat nga një gjë e tillë deri mbasandej kur bëhet vonë. Në Bashkësi gradualisht do të mësohemi me një njohje dhe vlerësim të tillë
- *Zhvillimi i talentit dhe aftësisë dobiprurëse* - Ndryshe nga “organizmat” tjerë ku dominojnë jomerita, paaftësia, jociësia, puna e dobët etj, Bashkësia do të krijojë kushte të volitshme për mbizotërimin e aftësisë dhe talentit mbi të tjerat. Kjo sidomos është e mundshme pasi që shpenzimi i kotë e joracional i energjive në iluzionet politike do të eliminohet dhe se këto energji do të jenë të gatshme për zhvillime tjera frytëdhënëse.
- *Mënyra demokratike e vendosjes* - Mungesa e mënyrës demokratike e vendosjes ndër ne spjegohet me traditën tonë të gjatë të vendosjes autoritative të individit që nga Kryepari, Zoti i Shtëpisë, Kryetari i partisë etj. Asnjë nga subjektet organizative të momentit të sotëm nuk kanë një vendosje të mirëfilltë demokratike. Një mënyrë e tillë e vendosjes do të jetë cilësi e re që do ta krijojë Bashkësia e llojit të modelit të cekur më lartë. Ky do të ishte jo vetëm parim por edhe jetësim i një gjëje të tillë. Anëtarësimi i lirë, zgjedhja e delegatëve me vota të lira në çdo dy vjet, mbledhjet çdo tre muaj të Kuvendit me një raportim të punës dhe diskutim të lirë, janë kushte që sigurojnë jetësimin e mënyrës demokratike të vendosjes. Nën këto kushte Bashkësia nuk do të jetë e kontrolluar dhe e dirigjuar nga vetëm qoftë ndonjë parti apo grup politik, apo nga grupe tjera joformale si ato: “kosovar”, “lab”, “malok”, etj. Interesimi i individëve për t’u anëtarësuar do të përcaktojë përkatësinë e anëtarësisë.
- *Vlerësimi i punës së individit në bazë të rezultatit* - Puna e Bashkësisë do të jetë e organizuar përmes Kuvendit, ku punët i marrin përsipër kryetari, kryesia, kryetarët dhe anëtarët e grupeve veç e veç. Individit do të dijë saktësisht punën e vet të marrë përsipër dhe do të jetë përgjegjës vetëm për atë. Kjo do të krijojë mundësinë që kontributi i secilit të dihet dhe çmohet në bazë të rezultatit që faktikisht e tregon, dhe puna e dobët apo dëmi po ashtu të njihen dhe vlerësohen po në të njëjtën mënyrë. Kjo do të bëhet jo nga individit (psh kryetari), grup i ngushtë (psh grupi politik apo ndonjë tjetër joformal) por nga shumica e delegatëve të zgjedhur.
- *Mekanizmi i kontrollit* - Mundësia që delegati të interesohet, të dijë, të kontrollojë, të mbikëqyrë etj punën e kryetarit, kryesisë, dhe grupeve të punës do krijojë mekanizmin që dobësia të njihet herët, të faktikohet, dhe të merret masa adekuate për eliminim. Kjo do të ishte detyrë dhe e drejtë e delegatit. Në këtë mënyrë Bashkësia do të ketë pak dobësi, d.m.th. do të jetë shumë e shëndetshme.

- *Informimi mbi punën dhe aktivitetet e Bashkësisë* - Veçoria e sistemit të informimit, “fjala në vesh” si dhe e “të informuarit nga kanale të thella”, apo nga rrethe të ngushta, do të shndërrohet në informim të barabartë e formal si detyrë e kuvendit për secilin delegat dhe anëtarë të Bashkësisë. Janë tri situata kur puna fshehet nga të tjerët: *i)* Punët e rëndësishme së madhe apo siç thotë populli “punët që i dijnë fëmija, nuk ka hajr shtëpia”, *ii)* kur dëshirohet të mbulohet ndonjë fëlliqësirë, dhe *iii)* kur brenda është bosh e provohet që të tjeret të mendojnë se “xhevahirët”, “sekretet”, “punë shumë të larta” janë duke mos u treguar. Bashkësia Kulturore Shqiptare nuk ka punë të llojit të parë, kurse nuk ka nevojë për punët e llojit të dytë apo të tretë.
- *Bashkësia në interes të anëtarëve* - Subjektet tjera organizative funksionojnë në emër të interesave të ndryshme dhe luajnë me nevojat e njerëzve, por që në realitet punojnë plotësisht në interes të “disave”, ku bile në shumë raste “këta” sillen sikurse e tëra është e tyre. Kjo bëhet meqë ato nuk e kanë strukturën e brendshme dhe nuk i zbatojnë parimet që Bashkësia do t’i këtë. Njeriu është “i poshtër aq sa i ka mundësitë për të qenë i poshtër”. Subjektet tjera ua krijojnë mundësinë për t’u bërë “të poshtër” gjë të cilën Bashkësia nuk do t’ua krijojë.
- *Kultivimi i kulturës së respektit ndaj të mendaurit ndryshe* - “Ndëgjueshmëria” dhe “bindja e verbërt”, janë si pasojë e formave të deritanishme të organizimit dhe jetës ndër ne. Të menduarit ndryshe nuk është njohur, respektuar dhe përfillur sidomos në traditën tonë të familjes dhe në sundimin dhe organizimin monist të jetës. Bashkësia do të mundësoj cilësinë e re të përdorjes së mendimeve të ndryshme si një pasuri dhe begati e jo si burim i ngatërresave.
- *Kultivimi i kulturës së gjetjes së marrëveshjes* - Në punën e Bashkësisë në bazë të principeve të cekura më lart, delegatët do të gjenden para dy rrugëve: ajo e “luftës” ndërmjet veti derisa të vijë Franc Vranicki e të ndërmjetsoj dhe ajo e gjetjes së pikëpamjeve të përbashkëta dhe arritjes së marrëveshjes. Kushtet e punës së Bashkësisë do të diktojnë që ata të zgjedhin këtë të dytën.
- *Edukimi i inivideve* - Individët janë të këqijë apo të poshtër, jo se janë lindur të tillë, por për arsye se për këtë u krijohet mundësia. Eliminimi i këtyre mundësive ata gradualisht do t’i edukoj dhe shndërroj në individ më të mirë.
- *Forcimi i ndjenjës dhe i besimit të drejtë* - Periudha shumë e gjatë e mbizotërimit të “farës së keqe” (mjeshtresë së rrenës, mashtrimit, dallaveve, tradhtisë, etj) ka bërë që të vijmë në situatë ku shumica i besojnë asaj si diçka e pathyeshme, e nevojshme, e pandryshueshme, dominuese, e përjetshme dhe se çdo përpjekje tjetër është e kotë! Kjo është duke bërë rekrutimin e vazhdueshëm të individëve në atë besim. Bashkësia me krijimin e kushteve për njohje dhe vlerësim të drejtë të punës së sinqertë, mundit, kontributit, dijes, aftësisë, sakrificës, rezultatit, etj. do të dëshmojë se “fara e keqe” është e thyeshme, e ndryshueshme dhe nuk është dominuese dhe e përhershme.
- *Bashkësia si element integrimi i kombit shqiptar* - Periudha mijërvjeçare e të qenurit nën sundime dhe ndikime të popujve dhe kulturave të ndryshme ka bërë që shqiptarët sot të jenë të ndarë e të përçarë. Bashkësia Kulturore Shqiptare me parimet që ka në themel të saj do të jetë një element i rëndësishëm në integrimin e shqiptarëve si komb. Këto parime janë të njëjta apo të ngjashme me parimet që kombet tjera i kanë mishëruar në jetën dhe institucionet e tyre shumë kohë më parë. Kjo u mundëson shqiptarëve që të integrohën si komb dhe të jenë të pranuar në familjen e kombeve tjera.
- *Të mirat materiale dhe kulturore do të jenë të mbrojtura dhe të ruajtura* - Me një procedurë të tillë ndaj mjeteve të Bashkësisë dhe me një punë përmes Kuvendit, të mirat materiale dhe kulturore do të jenë nën një mbikëqyrje të vazhdueshme dhe me mundësi të mëdha të rritjes të tyre. Anëtarët e Bashkësisë dhe të tjerët, lirisht do t’i paguajnë biletat e hyrjes së shfaqjeve kulturore, këngëtarët dhe aktorët do të kërkojnë më pak para për punën e tyre, dhe individë, institucione apo qeveri të ndryshme me lehtë do të japin donacione kur e dijnë se ato nuk vidhen a keqpërdoren nga individ të ndryshëm.

- *Mundësia e të filluarit me pak dhe e rritjes organike* - Mbrojtja dhe mirëmbajtja e mjeteve të Bashkësisë siguron anëtarët të fillojnë me pak, për shembull 30-50 anëtarë me organizimin e ndonjë koncerti a shfaqjeje kulturore, dhe të rrisin Bashkësinë me numër më të madh të anëtarëve si për shembull 500 - 1000, punësim të disave në punët e Bashkësisë, financim të projekteve të ndryshme shkencore etj.
- *Këmbimi kulturor me kombet tjera* - Me çthurjen e bazës së shoqërisë moniste, ndër shqiptarët pothuaj se u shua këmbimi i organizuar kulturor me kombet tjera. Shqiptarët në mërgim meqë jetojnë në shtetet dhe kulturat e kombeve tjerë, do të duhej që ta kenë më lehtë të bëjnë një këmbim të tillë. Kjo deri më tani pothuaj ka munguar dhe Bashkësia Kulturore Shqiptare do të ofronte mundësi që kjo të bëhet në një nivel më të lartë.
- *Bashkësia si institucion qytetar i formuar dhe i kontrolluar nga qytetarët* - Baza mbi të cilën Bashkësia krijohet dhe funksionon janë qytetarët me nevojat e tyre, si dhe shërbimet që Bashkësia u ofron në plotësimin e këtyre nevojave. Kjo do të jetë "kandari" i dallimit nga subjektet tjera që formohen dhe thirren në nevojat e njerëzve por që funksionimi i tyre është diçka tjetër (psh interesi i ndonjë grupi politik, individëve të caktuar, etj). Qytetarët do të anëtarsohen, do t'i zgjedhin njerzit që i dëshirojnë vetë dhe do t'i vlerësojnë ata në bazë të shërbimeve që do t'i marrin nga Bashkësia.
- *Puna shumë më racionale* - Struktura dhe metoda e punës së Bashkësisë është që raportet e punës së Kryesisë apo grupeve të përgaditen me shkrim, t'u shpërndahën delegatëve dhe se qëndrimet e ndryshme të dokumentohen. Kjo eliminon praktikën e subjekteve tjera të diskutimeve të mundimshme, të pafundme, e boshe, dhe pa ndonjë përfundim a qëndrim të mirëfilltë.
- *Ndarja nga grupet politike* - Eliminimi i mundësisë që kryetarët dhe anëtarët e degëve dhe nëndegëve të partive politike të zgjedhen kryetar, anëtarë kryesisë, apo kryetar grupi do të krijojë situatën ku mendjet politike do të jenë të preokupuara me punë politike, dhe mendjet kulturore dhe të tjera të jenë të preokupuara me punë kulturore dhe punë të tjera. Kjo do të rritë efikasitetin dhe cilësinë e punës së tyre. Individët do të lirohen nga euforia, iluzionet, shpresat dhe ëndrrimet joreale, preokupimet e pafrytshme dhe besimet joracionale të politikës, për t'u marrë me jetën që vërtetë e ndeshin; punën, problemet, nevojat, interesat dhe dëshirat e përditshme. Kjo do të racionalizojë energjitë tona kombëtare si rezultat i zvoglimit të harxhimit të potencialeve jokrijuese dhe rritjes e zhvillimit të atyre krijuese. Nga kjo dobia do të jetë e pakrahasueshme.
- *Shkarkimi nga detyra e individit, kryesisë, apo grupit* - Ndryshe nga subjektet tjera ku personi nuk mund të lirohet nga obligimet derisa të tërhiqet për krahu, Bashkësia këtë do ta bëjë me gjithë kuptimin e fjalës. Kjo bëhet ngase Bashkësia do t'i ketë strukturën dhe procedurat e qarta ndërsa subjektet tjera jo. Kuvendi do t'i njuh punët e ngarkuara në individ, grupe dhe kryesi dhe kur këto punë shihet se nuk po kryhen, do të marrë vendime për ndërrim e tyre.
- *Pamundësia e monopolit të pozitive* - Edhe pse monizmi si sistem ka kaluar që sa vite, në kokat e individëve mënyra e tillë e veprimtari ende është e paprekur. Kurrsesi nuk dënojnë të punojnë ndryshe. Ndarja e punëve në Bashkësi ata do t'i mësojë me cilësi të re. Kjo do të arrihet me pamundësinë që kryetari, anëtarët e kryesisë dhe kryetarët e grupeve të mbajnë pozita tjera, dhe me përgaditjen dhe me udhëheqëjen e punës së kuvendit nga një grup i veçantë e jo nga Kryesia.
- *Ndjenja se kontributi i bëhet Bashkësisë* - Derisa në subjektet tjera puna dhe kontributi i individit ndjehet se i bëhet individit të caktuar apo disave, në Bashkësi kjo nuk do të ndjehet. Kjo arrihet për arsye se subjektet tjera nuk kanë funksione kontrolli dhe bëhen funksion i qëllimeve dhe interesave të një individ apo disave, kurse Bashkësia do të jetë vetëm funksion i anëtarëve që e kanë formuar, e kontrollojnë dhe që u plotëson nevojat dhe interesat e tyre.
- *Institucion i qëndrueshëm, i fuqishëm, dhe i përhershëm* - Ndryshe nga subjektet tjera ku për shkak të dobësive të tyre janë të paqëndrueshme, të liga dhe që krijohen e shuhen apo shndërrohen në diçka tjetër,

Bashkësia do të jetë diçka krejt tjetër. Struktura e brendshme dhe metoda e punës do ta bëjë atë një institucion të rëndësishëm dhe të përhershëm kombëtar.

Këto përparësi dhe anë të mira të punës në bazë të parimeve të cekura më lartë nuk do të jenë të vetmet.

## Dobësitë dhe problemet e punës së Bashkësisë

Në punën e vet Bashkësia do të ketë edhe dobësi, pengesa dhe probleme të caktuara si:

- *Mënyrë e re e punës* - Kjo mënyrë e punës do të jetë diçka që anëtarët dhe të tjerët nuk e kanë përjetuar më parë, dhe se me vështirësi do ta kuptojnë. Delegatët nuk do të jenë në nivel të detyrës sidomos në fillim të punës. Të mësuarit me marrjen pjesë në tubime të ndryshme qytetare që u vetëquajshin kuvende, pa ndonjë përgaditje dhe seriozitet, vështirë se do të tejkalohet lehtë. Për nga natyra njeriu priton të futet në diçka të panjohur dhe të re. Personalisht e përjetoj me kënaqësi hyrjen në diçka për herë të parë.
- *Mbledhjet e gjata dhe të mundimshme të Kuvendit* - Askush nga ne nuk ka ndonjë traditë të punës racionale të kuvendit. Nevoja për njohjen dhe shoshitjen e problemeve do të krijojë situatën e diskutimeve të nxehta apo të pafundshme. Edhe kur diskutimet nuk janë aq të nxehta, ne nuk dijmë vijmë deri tek një perfundim i pranuar shpejt dhe në mënyrë racionale. Kjo do të zgjasë sidomos derisa të mësohemi të jemi efikas në punë.
- *Ndarja nga grupet politike* - Nuk besoj se ka "politikan" që mund të se mendojë se nuk duhet t'i "drejtoj masat" dhe "prijë" çdo zhvillimi. Sidomos ata politikanë që preokupimet politike i kanë të fundit. Do të çirren e bërtasin në çkado, në ide, ideologji, moralitet, patriotizëm, zgjuarësi politike etj, e do të bëhen lepuj e luajë, vetem e vetëm ta vazhdojnë veprimtarinë e tyre. Me kohën do të binden edhe ata me arsyeshmërinë e një ndarje të tillë.
- *Ndarja në mes të asaj që është personale dhe asaj që është të përbashkët (Bashkësisë)* - Diskutimi, vërejtja, qortimi, shkarkimi, sado të arsyeshme të jenë, do të jetë vështirë të kuptohen si diçka në interes të Bashkësisë dhe do të merren si personale. Kjo dukuri është e shprehur fuqishëm pothuaj tek të gjithë individët pa marrë parasysh se në cilin subjekt janë të angazhuar. Me kohën, me punën përmes institucionit të Bashkësisë këto dallime do të bëhen të dallueshme dhe të kuptueshme për secilin.
- *Matja e kontributit apo dëmit të punës së anëtarit* - Një nga parimet e Bashkësisë, si matja e kontributit apo dëmit të anëtarit me punën a sjelljen e tij/saj, do të jetë vështirë e zbatueshme. Të rallë janë ata/ato ndër ne që kan mprehtësi mendore që këtë punë ta bëjnë para se të bëhet vonë. Deri më sot nuk njoh ndonjë rast të mirëfilltë të një njohje dhe matje të tillë në asnjë formë të deritanishme të veprimit. Do të nevojitet një kohë derisa të jemi në gjendje që këtë ta bëjmë me një bisedim dhe ballafaqim të shtruar.
- *Largimi nga parimet e punës* - Tendenca e fuqishme që çdo gjë të vëhet si mjet i përfitimeve vetem të interesave personale të ngushta ka shkatërruar deri më tani secilin institucion. Bashkësia me strukturën që do të ketë, ka disa pengesa për të ndaluar këto tendenca të marrin fuqi. Ekziston rreziku që kjo tendence e fuqishme të arrijë ta largojë Bashkësinë nga parimet e saj, dhe ta shkatërroj atë. Nuk besoj se kjo tendencë do të shuhet ashtu vetvetiu.
- *Njohja e individeve të përshtatshem për delegatë* - Njerëzit do të jenë të zënë me punë dhe do të jenë të shpërndarë nëpër vendbanime larg njëri-tjetrit. Kjo do të krijojë vështirësi për njohjen e më të mirëve dhe më të merituarëve për besimin e detyrave të delegatit. Botimi i ndonjë gazete a magazine, si dhe mbremjet e shpeshta shoqërore mund të ndihmojnë shumë në këtë drejtim.

- *Mbizotërimi i primitivizmit të rajonalizimit* - Kjo është gjithashtu tendence e fuqishme. Edhe për këtë Bashkësia i ka të vëna disa pengesa por fakti se nga Kosova mërgimtarët janë të shumtë dhe të hershëm (e kam fjalën për valën më të re), është vështirë të perballohet kjo tendencë. Do të përkujtuar të gjithëve se identifikimi “kosovar”, etj. çon vetëm në përfitimin e disave (atyre që i marrin votat dhe pozitat), kurse e shkatërrojnë interesin e përbashkët të të gjithë të tjerëve (Bashkësinë). Këta “disa” përfitojnë në kurriz të “vendasve” (atyre që i votojnë), dhe në dëm të të tjerëve. Kjo i rritë dallimet jonatyrore në dëm të atyre natyrore të individëve, dhe kështu e mbytë cilësinë.
- *Heqja dorë nga përfitimet* - Një numër bukur i madh i individëve kanë bërë përfitime nga “identifikimet” e cekura më lartë, dhe marifetllëqe të tjera. Ata janë infiltruar dhe ngulitur thellë nëpër subjektet tona të ndryshme organizative prej nga ose janë duke përfituar ose janë në pritje të përfitimit. “Aktivistë” të shumtë janë duke organizuar koncerte, mbledhur ndihma “humanitare” për vatanin, apo “shteti amë u katandis” e i mbushin xhepat e tyre, e ku bile shumë i vlerësojnë “sa i zoti”. Kjo “zotësi” e tyre është marria e të gjithë neve që u krijojmë mundësi për një gjë të tillë. Këta individë do t’i bëjnë njëmijë dredhi, rrena e mashtrime për t’i vazhduar “aktivitetet” e tyre. Kjo do ta veshtirësojë punën e Bashkësisë për një kohë të gjatë.
- *Ndarja në mes të dallimeve natyrore dhe të atyre jo natyrore të individëve* - Individët jo aq lehtë do pranojnë dallimet e natyrshme si aftësia, zotësia, dituria, mençuria etj. dhe të heqin dorë nga dallimet jonatyrore si identifikimi dhe mëveshja politike, rajonale, shtresore, gjinore, etj. Kjo bëhet meqë individë të shumtë me vetëdije janë bërë sahanlëpirësa dhe dyfytirësha për të përfituar nga mbajtja e dallimeve të panatyrshme. Më kohë kjo gjendje do të përmirësohet.
- *Ndarja nga ushtrimi i kontrollit* - Individët kanë bërë përfitime nga mbajtja nën kontroll e tërë subjekteve organizative, ku edhe shumë i kanë përsosë lojërat dhe metodat e mashtrimit, manipulimit, paraqitjeve të rrejshme dhe kokorizjeve në gjithçka që vetëm të vijnë në këtë pozitë. Këta individë të rryer, këto “talente” të rralla do t’i ushtrojnë edhe për një kohë derisa plotësisht t’u bëhet e pamundur dhe t’u zbulohet fytyra e vertetë.
- *Uzurpimi i punës dhe mjeteve të Bashkësisë* - Këtu në Londër, “disa” kanë arritur që të krijojnë një strukturë të atillë ku plotësisht e kanë punën dhe mjetet e Bashkësisë Shqiptare “Faik Konica” në duart e tyre. Tendencja e tillë e uzurpimit të mjeteve të subjektit është shumë e fuqishme dhe prezente kudo, pra do të jetë edhe në punën e Bashkësisë Kulturore Shqiptare. Struktura e Bashkësisë së paraqitur këtu ka disa pengesa kundër kësaj tendence. Numri i 50-60 delegatëve të zgjedhur me mandat dyvjeçar besoj se është vështirë të futet nën kontrollin e vetëm një grupi apo “disave”. Megjithatë, përpjekja e tillë do të jetë prezente edhe në të ardhmen.
- *Kontrolli nga delegati/delegatja* - Ka individë që po u gjend p.sh. në pozitën e kryetarit apo ngjashëm, kur t’i thuhet se delegati mund ta kontrollojë punën e tij/saj, do t’i bie pika në zemër. Kjo do të pranohet me vështirësi për një kohë dhe do të sjellë probleme.

Do të deshiroja që këto probleme dhe këto vështirësi të jenë të vetmet.

## PËRFUNDIM

Dukuria e migrimit dhe levizjës së njerëzve nuk është vetëm e kohëve më të reja, por diçka që ka qenë prezente gjatë tërë historisë njerëzore. Derisa në kohët më të vjetra karakteristike më e theksuar ishte lëvizja e njerëzve në numër të madh dhe në grupe, në kohët më të reja më i dalluar është migrimi i individëve në kërkim të një jete më të mirë si diçka spontane dhe e vazhdueshme. Këto ecuri nuk janë dukuri vetem e shqiptarëve por e të gjithë popujve të botës. Jeta e vështirë dhe pazhvillueshmëria ka bërë që numri i të emigruarëve shqiptar të jetë shumë i madh. Edhe kur të arrihet liria dhe pavarësia e Kosovës, njerëzit do jenë në kërkim të një jete më të mirë. Kur emigrimi është gradual dhe i vazhdueshëm, krijimi i ndonjë subjekti të përshtatshëm organizativ është më i nevojshëm dhe më i dobishëm. Nevojat, interesat dhe dëshirat e njerëzve për një jetë të organizuar janë të mëdha dhe po ashtu kushtet, potencialet dhe mundësitë parktike janë në nivel të kënaqshëm. Krejt çka lypset është që këto të puqen së bashku. Individë të vyeshëm ndër mërgimtarët shqiptarë janë duke krijuar mirëqenje, pasuri e të mbërrime profesionale, por ata nuk po i shijojnë këto me kënaqësi në mungesë të një niveli më të lartë të përgjithshëm zhvillimor. Këto të mira janë disi të shkapërderdhura, pa ndonjë ndërlidhje, dhe ashtu siç janë, do të krijohen e shuhën pa lënë ndonjë gjurmë. Mërgimtarët kanë nevojë për një zhvillim kulturor dhe për këtë mundësitë janë në nivel të kënaqshëm. Potenciale të mëdha kombëtare janë duke u krijuar në mërgim, ku një përdorim dobiprurës i tyre është më se i nevojshëm. Formimi i subjekteve organizative, në përputhje me nevojat e mërgimtarëve, krijimi i strukturës së brendshme bashkëkohore të tyre, ngritja e profesionalizimit në punë, ndarja dhe kordinimi përmes Këshillit të Përbashkët, në mënyrën se si është paraqitur këtu, do të mundësonte shfrytëzimin racional të energjive tona kombëtare. Bashkësia e modelit të paraqitur këtu, qëllim i ka nevojat e mërgimtarëve dhe ofrimin e shërbimeve për plotësimin e tyre dhe strukturën e brendshme organizative e cila siguron arritjen e qëllimit. Kjo bëhet pasi që kjo struktur lejon punën e tri funksioneve themelore të nevojshme për punë normale të cilitdo organizim. Punët e Bashkësisë janë të ndara nëpër individë, grupe dhe kryesi ku kuqendi do t'i njohë dhe vlerësoj në çdo tre muaj kryerjen apo moskryerjen e tyre. Matja e rezultatit dhe suksesit është lehtësisht e mundshme, ku suksesti i Bashkësisë do të matet me rritjen apo zvoglimin e numrit të anëtarëve dhe rezultati i punës së individit, grupit apo kryesisë do të matet me punët e përcaktuara apo të marra përsiperë. Anëtari i Bashkësisë do të jetë në gjendje t'i vlerësoj shërbimet e marra nga Bashkësia dhe do t'i krahasoj me çmimin e anëtarësisë që e paguan. Edhe pse ndoshta më së miri do t'i përshtatej rrethanave të Londrës, ky model është i zbatueshem tek mërgimtarët kudo që janë. Parimet e punës së këtij modeli janë të drejta, të sqnqerta dhe të zbatueshme në punën e cilitdo subjekt organizativ. Këto parime sigurojnë punën, zhvillimin, rritjen, si dhe ndryshimin dhe përshtatjen e përhershme. Struktura e brendshme organizative krijon kushte dhe mundëson zbatimin e këtyre parimeve. Institucionet e fuqishme të kombeve që në i njohim si të zhvilluara, këto dhe parime të tjera të ngjashme i kanë jetësuar shumë kohë më parë. Parimet dhe struktura e Bashkësisë u krijojnë mërgimtarëve një institucion të qëndrueshem, të fuqishëm dhe të përhershëm. Bashkësia Kulturore Shqiptare do të jetë shtylla e zhvillimit tonë kulturor dhe të përgjithshëm kombëtar në mërgim.